



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1911 / 11 prot.

Tiranë, më 04.07.2019

VENDIM

Nr. 36, datë 04.07.2019

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË STUDIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË, TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË DHE CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE "MASTER I SHKENCAVE" NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

Në mbështetje nenit 3, pika 3 dhe të nenit 6, pika 31 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", pasi mori në shqyrtim Vendimin e Senatit Akademik Nr. 45, datë 17.05.2018 "Për tarifat e aplikimit dhe studimit për programet e cilit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019", në zbatim të pikës 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë....", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e studimit për programet e cilit të parë, të programeve të integruara të ciklit të dytë dhe ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2019-2020.
2. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në programet e studimeve të ciklit të parë me kohë të plotë, programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë dhe ato të ciklit të dytë "Master Profesional" dhe "Master i shkencave" në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për vitin akademik 2019-2020, pasqyrohen në tabelat 1, 2 dhe 3 bashkëlidhur dhe pjesë integrale e këtij vendimi.
3. Tarifa e aplikimit për programet e ciklit të dytë është 2,000 (dy mijë) lekë, ndërsa tarifa e aplikimit për një program të dytë të studimi është 10,000 (dhjetë mijë) lekë.



4. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues në një program studimi është 2,000 (dymijë) lekë.
5. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i ciklit të parë të studimeve dhe të integruar të ciklit të dytë, i cilësuar në bazë të rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdon studimet. Student përsëritës konsiderohet student i qe nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve për të kaluar në vitin pasardhës.
6. Studentët, qe transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi në një program tjetër studimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.
7. Studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij, dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik tarifën për kredit për lëndët përsëritëse.
8. Shtetasit e huaj, qe vazhdojnë studimet në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në një program të parë apo të dytë studimi, i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë qe vazhdojnë studimet në programet respektive, me përjashtim të rasteve kur me marrëveshje zyrtare janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të institucionit.

ZËVENDEËS KRYETARI

Florian TOTI

Tarifat e shkollimit për ciklin e parë të studimeve si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020.

Tabela 1

Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifa vjetore për program të dytë
Fakulteti i Mjekësisë	Program i integruar i ciklit të dytë	Mjekësi e Përgjithshme	45,000	
Fakulteti i Mjekësisë	Program i integruar i ciklit të dytë	Farmaci	45,000	
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Program i integruar i ciklit të dytë	Stomatologji	45,000	233,916
Fakulteti i Mjekësisë	Bachelor	Shëndet Publik	40,000	
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bachelor	Teknikë Dentare	40,000	
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bachelor	Higjienist Dentar	40,000	
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Infermieri e Përgjithshme	40,000	233,916
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Mami	35,000	233,916
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Fizioterapi	35,000	233,916
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Teknikë Laboratori	35,000	233,916
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Teknikë Imazherie	35,000	233,916
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bachelor	Logopedi	35,000	233,916

Tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional, me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020.

Tabela 2

Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifë për kredit
Fakulteti i Mjekësisë	Master Profesional	Menaxhim Shëndetësor	72,000	1,200
Fakulteti i Mjekësisë	Master Profesional	Shëndet Publik	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Infermieri e Përgjithshme	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Mami	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Fizioterapi	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Teknikë Laboratori	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Teknikë Imazherie	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Logopedi	72,000	1,200
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional	Kujdes Paliativ	72,000	1,200

Tarifat e shkollimit për ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave, me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020.

Tabela 3

Fakulteti	Cikli i studimit	Emërtimi i programit të studimit	Tarifa vjetore për program të parë	Tarifë për kredit
Fakulteti i Mjekësisë	Master i Shkencave	Shëndet Publik	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Infermieri e Përgjithshme	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Mami	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Fizioterapi	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Teknikë Laboratori	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Teknikë Imazherie	105,000	1,750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave	Logopedi	105,000	1,750